

Nr. 316-01/24
Data: 18.04.2024
Bujanoc

Në bazë Nenit 113 paragrafi 2 pika 1 të Ligjit për Këshillat Kombëtare të Pakicave Kombëtare (Fletorja zyrtare R.S. 72/2009,20/2014 - vendimi i GJK 55/2014 dhe 47/2018) dhe neni 14, paragrafi 1, pika 3 dhe 20 e Statutit të Këshillit të Kombëtar Shqiptar, nr.284-01/23 të datës 06.07.2023, si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar Shqiptar nr.316-01/24, datë 18.04.2024, shpall:

THIRRJE PUBLIKE

PËR ORGANIZATAT QË KANË NË FOKUS AVANCIMIN DHE SOCIALIZIMIN E FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Ftohen të gjitha organizatat/shoqatat e shoqërisë civile që të aplikojnë për mjete financiare që Këshilli Kombëtar Shqiptar ndan në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 08/L-260 nga organizata buxhetore Zyra e Kryeministrit me kod 104, nën-programi “Përkrahje për Luginën e Preshevës” me kod 39100, kategoria e shpenzimeve “Subvencione dhe Transfere”.

Qëllimi specifik i thirrjes së përgjithshme publike është promovimi, edukimi dhe forcimi i identitetit të shqiptarëve në Republikën e Serbisë.

Shuma e përgjithshme e mjeteve financiare që do të ndahen sipas kësaj thirrjeje publike do të përcaktohet nga Këshilli Kombëtar Shqiptar, me vendim të veçantë.

E drejta për të marrë pjesë

Organizatat/shoqatat e shoqërisë civile të regjistruara në regjistrin përkatës, qëllimet e të cilave sipas dispozitave statutores, kanë në fokus avansimin dhe socializimin e fëmijëve dhe nxënësve me nevoja të veçanta në ente parashkollore dhe shkolla fillore, të cilat e kanë selinë në territorin e Luginës së Preshevës (në tekstin e mëtejshëm: pjesëmarrës në thirrjen publike).

Pjesëmarrësi i thirrjes publike mund të konkurrojë vetëm me një program/projekt.

Kriteret për vlerësimin e programeve dhe projekteve

Përzgjedhja e programeve dhe projekteve që do të financohen me mjete nga fondi i Qeverisë së Republikës së Kosovës bëhet duke përdorur kriteret e mëposhtme:

1. në çfarë mase programi dhe projekti i përshkruar korrespondon me arritjen e objektivave të programit dhe projekteve të përcaktuara në ftesën publike;



KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTARE
НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЃИНЕ
NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY

2. kohëzgjatja për projektet për fëmijët me nevoja të veçanta 12 muaj;
3. mundësia e zhvillimit të mëtejshëm dhe qëndrueshmërisë së programit dhe projektit;
4. cilat janë grupet e synuara për të cilat programi dhe projekti është dedikuar;
5. kapacitetet e organizatës që nevojiten për arritjen e qëllimeve;
6. Arsyetimi i buxhetit të programit dhe projektit.

Kriteret shtesë

1. Projekti që do t'i zhvillojë aktivitetet e tij në Luginë të Preshevës;
2. Projekti i cili do të përfshijë fëmijët me nevoja të veçanta nga komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, të nacionalitetit shqiptar;
3. Aplikuesi i fondit duhet të ketë më së paku 5 vjet përvojë në fushën e kërkuar.

Mënyra e financimit

Këshilli Kombëtar Shqiptar dhe përfituesi që është përfitues i mjeteve do të lidhin kontratën mbi rregullimin e të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësive reciproke të palëve kontraktuese. Pas nënshkrimit të kontratës, mjetet i barten përfituesit të mjeteve në xhironlogari të dedikuar për projektin, të hapur **pranë Departamentit të Thesarit të Ministrisë së Financave/bankë**. Të gjitha aktivitetet e projektit financohen nga kjo llogari, në përputhje me buxhetin e miratuar. Çdo transferim i mjeteve nga kjo llogari në një llogari bankare tjetër nuk lejohet. Çdo transferim i mjeteve në llogarinë tjetër të bankës do të konsiderohet si përdorim jashtë dedikimit i mjeteve dhe Këshilli Kombëtar Shqiptar do të kërkojë kthimin e mjeteve me kamatë.

Përdoruesi i mjeteve është përgjegjës për përdorimin ligjor dhe të synuar të mjeteve.

Shpenzimet që mund të parashikohen në buxhetin e programit/projektit

Shpenzime të pranueshme për këtë konkurs konsiderohen:

- shpenzimet që lidhen me zhvillimin e aktiviteteve të planifikuara të projektit;
- shpenzimet për burimet njerëzore që lidhen me tarifat e personave të angazhuar në zbatimin e programeve dhe aktiviteteve të projektit (edukatorë, trajnerë, asistentë etj.);
- shpenzimet administrative.

Shpenzimet e ushqimeve dhe pijeve të bëra për realizimin e aktiviteteve të programit/projektit nuk mund të jenë më shumë se 15% e vlerës totale të mjeteve të planifikuara dhe të fituara për realizimin e programit/projektit. Shpenzimet e ushqimit dhe pijeve të bëra për arsye të tjera mbi këtë përqindje nuk do të njihen.

Nuk do të financohet asnjë program/projekt që parashikon:

- blerjen e pajisjeve teknike për nevojat e organizatës/shoqatës dhe adaptimin e hapësirave të institucionit/shoqatës/organizatës (vlera e të cilave kalon 20 % e vlerës totale të projektit të miratuar);
- ndërtimin e infrastrukturës dhe punimeve ndërtimore në kuadër të aktiviteteve programore;
- qiranë për shfrytëzimin e hapësirave/lokalit për punën e institucionit/shoqatës/organizatës, si dhe shpenzimet e energjisë elektrike, telekomunikacionit dhe shërbimeve komunale;
- financimin retroaktiv të programeve/projekteve, realizimi i të cilave është në zhvillim e sipër ose realizimi i të cilave ka përfunduar.

Nëse përfituesi i mjeteve nuk i shfrytëzon mjetet nga paragrafi 2 dhe paragrafi 3 pika 1) në tërësi apo pjesërisht, atëherë këto mjete mund t'i përdorë në zhvillimin e aktiviteteve të programit/projektit.

Dokumentacioni i kërkuar

- Formulari i aplikimit i plotësuar dhe i vulosur e nënshkruar në pesë kopje (të shkarkuar nga faqja zyrtare e KKSh-së);

Përveç formularit të lartpërmendur, aplikanti mund të paraqesë dokumente të tjera që ai i konsideron të nevojshme dhe të përshtatshme për programin/projektin e propozuar (për shembull: letra rekomandimi, pëlqime, letra mbështetëse nëse ka, etj.).

Komisioni vlerësues ka të drejtë të kërkojë dokumente shtesë nga aplikuesi për të sqaruar çështje që kanë të bëjnë me vlerësimin e projektit.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve

Ftesa e përgjithshme publike shpallet në periudhën 19 Prill deri në 9 Maj 2024.

Mënyra e aplikimit

Aplikimet me dokumentacionin e paraparë dorëzohen personalisht në adresën: Këshilli Kombëtar Shqiptar, rr. Karagjorgje Petroviq 237, 17520 Bujanoc, me shënimin: **APLIKACION NË THIRRJE PUBLIKE PËR FËMIJËT ME NEVOJA TË VEÇANTA NË LUGINËN E PRESHEVËS**. Në anën e pasme të zarfit duhet të shkruani emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit.

Aplikacionet e dërguara në ndonjë mënyrë tjetër (me faks, e-mail, etj.) ose të dërguara në një adresë tjetër nuk do të merren parasysh.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet.



KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTARE
НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ
NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY

Nuk do të merren parasysh: aplikimet e parakohshme dhe të plotësuara gabimisht; aplikimet me dokumentacion jo të plotë; aplikimet që nuk janë dorëzuar në formularin përkatës dhe aplikimet që përmbajnë të meta të tjera që e bëjnë të pamundur përcaktimin e përmbajtjes reale të aplikacionit ose aplikimet që nuk mund të vlerësohen sipas kritereve të përcaktuara; aplikimet nga aplikantët që nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në konkurs; aplikacionet që nuk janë dorëzuar nga personat e autorizuar dhe aplikacionet që përmbajnë projekte dhe programe që nuk janë në përputhje me qëllimin e mjeteve të përcaktuara me këtë thirrje publike.

Lista e vlerësimit dhe rangimit të programeve dhe projekteve të paraqitura

Komisioni vlerësues përcakton Listën e vlerësimit dhe rangimit të programeve dhe projekteve të paraqitura brenda një afati që nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë nga përfundimi i afatit për aplikim dhe e publikon në faqen zyrtare të Këshillit Kombëtar Shqiptar.

Pjesëmarrësit në konkurs kanë të drejtën e ankimimit në Komisionin Ankimor të Këshillit Kombëtar Shqiptar - brenda tetë ditëve nga data e publikimit të Listës preliminare.

Vendimi sipas ankesës merret nga Komisioni Ankimor brenda 15 ditëve nga data e marrjes së ankesës.

Vendimi për pagesën e mjeteve merret nga Kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar, bazuar në Listën e vlerësimit dhe rangimit të programeve dhe projekteve të aplikuara, brenda 30 ditëve nga data kur Lista bëhet përfundimtare, përkatësisht nga bartja e mjeteve në llogarinë bankare të Këshillit Kombëtar Shqiptar nga Qeveria e Republikës së Kosovës - nëse këto mjete nuk janë të bartura në kohën kur kjo listë është bërë përfundimtare. Lista publikohet në vebfaqen e Këshillit Kombëtar Shqiptar.

Format për aplikim si dhe të gjitha informatat tjera gjinden në kksh.org (website i KSSH-së). Për informata shtesë ju lutem na shkruani në kksh.grantet@gmail.com ose na telefononi në nr. **0631408945**.

